

## FESTIVALET

Ferizaj shquhet edhe me organizimin e festivaleve të ndryshme si të teatrit, këngës, filmit, muraleve, si dhe atyre për fëmijë. **Festivali i Teatrove** është festivali më i vjetër në Kosovë, i cili organizohet kryesisht në muajin Tetor dhe është ndër ngjarjet më të mëdha kulturore të vitit në Ferizaj. **Festivali i Këngës “Kosovarja Këndon”** është gjithashtu ndër festivalet më të vjetra në Kosovë, i cili organizohet në muajin Nëntor. **Festivali i Filmit “FERFILM”** është festivali i parë ndërkombëtar që mbahet në Ferizaj nga fusha e kinematografisë. **Festivali i Muraleve “Mural Fest Kosova”** ka për qëllim promovimin e artit dhe kulturës në vend. Gjithashtu në Ferizaj organizohen disa festivale për fëmijë, si: **Festivali “Fëmijët e Gëzuar”, Festivali i Recitatorëve, Festivali “Diamond Fest”, Festivali “Sidorela”, Festivali “A-Mol”.**



## RRETH FERIZAJT

Ferizaj, ofron për turistët atraksione të ndryshme për tu vizituar, si lokacione të rëndësishme arkeologjike, si dhe objekte me karakter kulturore e historik. Për më tepër, Ferizaj karakterizohet me pasuritë natyrore, përfshirë peisazhin e jashtëzakonshëm, varmalet që qarkojnë një pjesë të konsiderueshme të territorit të Ferizajt, me pikë reference fshatin Jezerc.

Ferizaj është qytet i ri, por rrethina e tij ka qenë e banuar që nga mijëvjeçari VI p.e.s. Nga gjetjet arkeologjike në fshatin Varosh, 3 km në jug të Ferizajt, dëshmohet se këto anë kishte një qytetërim që në kohën e neolitit të hershëm. Andaj, nga shekulli VIII para Krishtit e deri në pushtimin romak, Ferizaj dhe rrethina e tij u banua nga popullata dardane. Tumat varrore dardane janë gjetur në rajonin e Ferizajt, në Gërlicë (Gurëz) gjithsej 18 varreza, të cilat i përkasin shekujve VIII-VII, dhe më pas nekroplet tumulare në Zaskok.

Qyteti i Ferizajt ka pozitë qendrore ndaj territorit të komunës, ku lartësia mbidetare e qytetit është rreth 580 metra mbi nivelin e detit. Ferizaj ka një pozitë shumë të mirë gjeografike, duke qenë se shtrihet në pjesën ku janë kryqëzuar rruget e vjetra Prizren - Anamoravë dhe rruga Prishtinë - Shkup.



☎ 038 200 460 76




✉ info@visit-ferizaj.com

🌐 visit-ferizaj.com

# INFORMATOR TURISTIK



## FERIZAJ



## LOKACIONET ARKEOLOGJIKE

Ekzistojnë disa lokacione arkeologjike, të cilat janë pjesë e trashëgimisë kulturore, ndër këto duhet veçuar **Kishën Dardane** në malet midis fshatrave Komogllavë, Sojevë e Fshat i Vjetër, **ujësjellësi i kohës Ilire-Romake** në fshatin Komogllavë, i cili furnizon me ujë të pijes edhe sot disa familje, tumat (varrezat) Ilire në fshatin Varosh, **Kisha paleokristiane** në Nikadin, që i përket periudhës romake të fundit të shekullit III e.s. dhe fillimi i shekullit të IV e.s., mbetjet e qytetit të vjetër në Jezerc, gërmadha të kohëve të ndryshme në Neredime etj.

## OBJEKTET KULTURORE

Pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore janë gjithashtu objektet me karakter të ndryshëm siç është **Biblioteka Publike "Sadik Tafarshiku"**, **Teatri i Qytetit "Adriana Abdullahu"**, **Ndërtesa Stacioni i Trenit**, disa mullinj si: **Mulliri i Nikës**, **Mulliri i Madh**, dhe **Mulliri i Selman Begës**. Objektet fetare gjithashtu pasurojnë trashëgimin kulturore, si: **Xhamia e Madhe** dhe **Kisha Ortodokse**, të cilat ndajnë një lokacion të përbashkët, **Kisha Katolike**, **Xhamia e Berishëve**, **Xhamia e Talinocit të Muhaxherëve**.

Vendet me rëndësi të vecantë historike si **Pika I e UÇK-së** dhe **Pika VI e UÇK-së** janë lokacione të rëndësishme turistike, të cilat prezantojnë luftën e UÇK-së në Zonen Operative të Neredimes gjatë luftës së fundit në Kosovë (1998-1999).

## ATRAKSIONET NATYRORE

Ndër vendet e rëndësishme në kuadër të atraksioneve natyrore, është **Bifurkacioni i Lumit Neredime**, si rasti i vetëm në Evropë ku një lum derdhet në dy dete. Lumi Neredime buron në bjeshkët e Jezercit dhe në fshatin Neredime ndahet në dy pjesë, gjegjësisht në dy degë, të cilat kanë derdhje në dy dete të ndryshme. Dega jugore (dega e djathtë) përmes lumit Lepenc dhe përmes lumit Vardar derdhet në detin Egje. Kurse dega tjetër derdhet në lumin Sitnicë dhe përmes këtij lumi në lumin Ibër derdhet në Detin e Zi. Gjithashtu, ekzistojnë atraksione të tjera të rëndësishme natyrore, siç janë: **Parku i Pishave në Rahovicë**, **Maja e Gurrethit**, **Bashkimi i dy lumenjëve**, **Ujëvara e Jezercit**, et., si dhe disa shtigje të rëndësishme për ecje në natyrë.